



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 60, Datë 02.04.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.97, DATË 09.05.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN E REMASIT-KARAVASTA, LUSHNJE DHE LIBOFSHË, FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 140MWP**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144/4 prot., datë 29.03.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 08.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Karavasta Solar Park 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit-Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140MWp”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.97, datë 09.05.2022 ka vendosur: 1) Të licencojë shoqërinë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën e Remasit-Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MWp, për një afat 30 vjeçar.2) Shoqëria të depozitojë në ERE, brenda datës 20.06.2022, përgjigjen/qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në lidhje me informacionin kadastral të Deklaratës Mjedisore për zhvillimin e projektit të Karavastasë. 3) ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë, në përputhje me plotësimin/mosplotësimin e kushtit sipas përcaktimeve të pikes 2, të këtij vendimi.
- Pas një korrespondence të gjatë të zhvilluar me vetë shoqërinë dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), rezulton se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin nr. 97/2022 të bordit të ERE-s, duke depozituar në ERE shkresat e

korrespondencës së mbajtur me AKM-në dhe qëndrimin e saj në lidhje me zhvillimin e projektit të Karavastasë.

- Shoqëria me shkresën nr. 736/11 prot., datë 12.03.2024 ka depozituar Certifikatën e Kolaudit sipas përcaktimeve të nenit 6 “Ndërtimi dhe Kolaudimi”, të marrëveshjes së zhvillimit datë 31.07.2020, për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e impianteve fotovoltaike me vendndodhje në Zonën Remas Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, Shqipëri” nga “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. dhe po ashtu ka raportuar se impianti fotovoltaik ka hyrë në prodhim.
- Për gjithë sa depozituar nga shoqëria, rezulton se kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit të bordit nr. 97, datë 09.05.2022 është plotësuar, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet. Me shfuqizimin e pikës 2, nuk gjen më zbatim as pika 3 e vendimit nr. 97/2022 dhe si e tillë vlerësohet të shfuqizohet dhe pika 3 e këtij vendimi.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 97/2022, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k. dhe Ministrinë e infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**